

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
KRYETARI

URDHËR
Nr. 41352, datë 20.12 2023

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të ligjit 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pikës 2 të nenit 8, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenet 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, si dhe në vijim të memos nr. 41352 prot., 23.11.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Marrëdhënieve me Publikun dhe Jashtë,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Bashkisë Tiranë, të parashikuara në ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, znj. Milena Sauku, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Marrëdhënieve me Publikun dhe Jashtë.
2. Delegimi i kompetencave, të parashikuara në pikën 1 të këtij urdhri, bëhet për të gjitha kompetencat për të cilat lejohet delegimi sipas pikës 2 të nenit 19, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, të ndryshuar.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Marrëdhënieve me Publikun dhe Jashtë, të marrë të gjitha masat e nevojshme për publikimin e këtij urdhri.
4. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e këtij urdhri.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, znj. Milena Sauku.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Erion Veliaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË